

Mekanizmat dhe procedurat e ndjekura nga ana e Bashkisë e Vau Dejes për t'u mundësuar qytetarëve që të japin mendimet e tyre apo të ndikojnë në hartimin e politikave publike apo të ushtrimit të funksioneve të autoritetit publik.

Bashkia e Vau Dejes në zbatim dhe të ligjit Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt akteve.

Siç është bërë tashmë evidente për të gjithë qytetarët, Bashkia e Vau Dejes ka dhënë informacion të vazhdueshëm në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Për të gjitha nismat që janë ndërmarrë apo projekte, ato pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, Bashkia ka organizuar konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Këto konsultime janë dokumentuar në procesverbale të cilat shqyrtohen nga specialistët dhe nëse ka rezultat e nevojshme janë reflektuar.

Vetëm për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar në Dhjetor 2016 nga Këshilli Bashkiak, Bashkia e Vau Dejes ka organizuar përtej 6 njësive dhe 3 dëgjësive ligjore, mbi 100 dëgjësia e takime me grupe interesi si Shoqata e Arkitektëve, grupe mjedisore apo Shoqatat e Ndërtuesve etj si dhe me qytetarë, ndërsa Buxheti i është nënshtruar konsultimeve publike në çdo njësi ku qytetarët kanë shprehur mendimet e tyre.

Për njoftimin dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, Bashkia e Vau Dejes ka përdorur një sërë mekanizmash si

- a) posta elektronike;
- b) lajmërimi publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;
- c) lajmërimet në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

Nisur dhe nga zhvillimi i teknologjisë, Bashkia e Vau Dejes i ka dhënë rëndësi dhe përdorimit të rrjeteve sociale për rritjen e transparencës dhe të informimit të qytetarëve.

Disa mekanizma të tjera përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimin e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimit të funksioneve janë si më poshtë:

- Sportelet e Drejtorisë së Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët
- Faqen zyrtare të Bashkisë Vau Dejes në Internet www.vaudejes.gov.al
- Adresën e email info@vaudejes.gov.al

- Posta
- Kutia postare e Kryetarit
- Takime individuale
- Dëgjesat publike
- Takimet në terren me komunitetin
- Grupet e këshillimit

Me qëllim rritjen e transparencës, dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjet dhe hartimin e politikave të Bashkisë Vau Dejes .